

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrest i ish-kreut të SHISH, PS: Të hetohet, s'jemi avokatë të askujt! Balla-opozitës: Fërkoni duart nga sukeset e SPAK, por prokurorët i sulmoni me
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/arrest-i-i-ishkreut-te-shish-balla-ps-nuk-eshte-avokate-e-askujt-skomentoj-dosjet-nen-hetim
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 11:05:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 11:02:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8b3ea607a291bb51d73b0330bb3b0292c26e7ab40912d85e23d3e3a6de58248c
TEKSTI	0a8d241a58032ebb8e51221d907f1eecb0b84aee41a09fbd3964f4771ba2f1f2
PAMJA	9044cdbb0105a42a62f8fe78ddefee2538034abc995118d45e02af6dcc2bbc23

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	087aa9e76fee08f7bd80245e2c168927e85e59574e9926b07107d1bafc8d1009
E MËPARSHMJA	66d00d4ec51f677e539f672dbb9a2d77c2f49dbca8755669bc2754104ca1bc59
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/087aa9e76fee08f7bd80245e2c168927e85e59574e9926b07107d1bafc8d1009>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për emërimin e saj në krye të SHISH?

Politikë

Arresti i ish-kreut të SHISH, PS: Të hetohet, s'jemi avokatë të askujt! Balla-opozitës: Fërkoni duart nga sukseset e SPAK, por prokurorët i sulmoni me 'libër shtëpie' (VIDEO)

Taulant Balla thotë se Partia Socialiste nuk është avokate e askujt dhe kushdo që akuzohet nga drejtësia do duhet të përballët në vetëm. Këtu i referohet rastit të ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hysenit, duke refuzuar të komentojë dosjen apo të flasë për përgjegjësitë politike të emërimeve të tilla.

■ 'Territorialja', Balla: PD ta shqyrtojë draftin e saj në këshillat bashkiakë! Votimi më 8 tetor? Kreu i grupit PS: Presim Komisionin e Ligjeve (VIDEO)



Redaksia

29 Shtator, 13:02 | Përditësimi: 29 Shtator, 14:19

f Share Tweet



A A

Qëndrimi i mazhorancës mbetet i pandryshuar për këdo nga radhët e socialistëve apo qoftë edhe të propozuar prej tyre që përballen me drejtësinë: Luftën do ta bëjnë të vetëm. I pyetur për përgjegjësi politike për rastin e Vlora Hysenit, ish-kreut të SHISH, kreu i grupit parlamentar socialist thotë se pas shkarkimit fjala i takon drejtësisë.



"Janë dy standarde që ky grup parlamentar, mazhorancë, shumicë, i ka përcaktuar. Ne nuk hyjmë në meritën e dosjeve, nuk komentojmë përmbajtjen e dosjeve dhe çdo zyrtar duhet ta kontestojë kufizimin e lirisë të të gjitha formave në gjykatë. PS nuk është avokate mbrojtëse e askujt. Në rastin e personave me mandat parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë përmes së drejtës që i ka dhënë sovranit, e ka ushtruar këtë të drejtë dhe dua të rishpreh që Shqipëria sa i përket pjesës që lidhet me kufizimet e lirisë para vendimit të gjykatës, duhet t'i japë fund kësaj praktike", tha Balla.

SPAK-ut thotë Balla, i ofrojnë mbështetje të pakufizuar. ndërsa për dy standarde në raport me drejtësinë e re, akuzon opozitën.



LEXO EDHE:

PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për emërimin e saj në krye të SHISH?



"Ne mbështesim SPAK të bëjë një hetim të pandikuar. Vlerësojmë punën e bërë nga SPAK. Rasti më domethënës është që i njëjti prokuror që heton rastin në fjalë, heton edhe udhëheqin e opozitës. Rama ka të njëjtin standard gjithmonë, edhe në rastin në fjalë. Janë ata që udhëheqësi i tyre shan me libër shtëpie prokurorët e SPAK, ndërkohë që standardi i PS, është që PS përshëndet në çdo rast punën hetimore të prokurorëve", vijoi ai.

I pyetur për ndarjen e re territoriale që pritet të votohet në parlament në datën 8 tetor dhe për akuzat e opozitës se po shkelin çdo procedurë parlamentare Balla u përgjigj kështu.



"Kur kam pasur ndonjëherë që kam dështuar në votime? Përshëndes faktin që PD ka kuptuar që në demokraci konkurohet me propozime. Ka ardhur një propozim, në ligj përcaktohet që çdo lloj drafti që vjen për ndryshime në hartën administrative-territoriale, duhet t'u shkojë këshillave bashkiakë. Në vlerësimin tim, para se t'i bashkohet procedurës parlamentare, duhet t'i bashkohet të njëjtit proces. Nuk është faji im që këta të shkretët janë gjithnjë të vonuar", u shpreh Balla.

Një ditë më parë në komisionin e ligjeve opozita kërkoi futjen në rendin e ditës edhe të propozimit të tyre për një ndarje të re territoriale me 100 bashki, në mënyrë që të dyja nismat të shqyrtohen në të

njëjtën kohë, por ky propozim u rrëzua nga mazhoranca me argumentin se duhet të kalojë në procedurë të rregullt parlamentare. Opozita nga ana tjetër paralajmëron se mund ta çojë çështjen në gjykatën kushtetuese.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 13:19

'Territorialja', Balla: PD ta shqyrtojë draftin e saj në këshillat bashkiakë! Votimi më 8 tetor? Kreu i grupit PS: Presim Komisionin e Ligjeve (VIDEO)

Partia Demokratike duhet të vijojë me konsultimin e propozimit të saj për reformën territoriale në bashkitë e vendit, tha [Taulant Balla](#). Ai refuzoi të komentonte nëse socialistët do ta votojnë draftin e tyre më 8 tetor, siç është parashikuar në kalendarin e Kuvendit duke u shprehur se gjithçka varet nga puna e Komisionit të Ligjeve.



"Kur kam pasur ndonjëherë që kam dështuar në votime? Do të presësh njëherë. Nuk komentoj pa mbledhjen e grupit parlamentar. Di që Komisioni i Ligjeve po bën një punë të shkëlqyer. Përsëritës faktin që PD ka kuptuar që në demokraci konkurrohet me propozime. Ka ardhur një propozim, në ligj përcaktohet që çdo lloj drafti që vjen për ndryshime në hartën administrative-territoriale, duhet t'u shkojë këshillave bashkiakë. Në vlerësimin tim, para se t'i bashkohet procedurës parlamentare, duhet t'i bashkohet të njëjtit proces. Nuk është faji im që këta të shkretët janë gjithnjë të vonuar. Në rastin tonë, procedura parlamentare i ka plotësuar të gjitha afatet. Nëse Komisioni do ta mbyllë, kalendarin e Kuvendit parashikon datën 8", tha Balla.

P.J/Shqiptarja.com

f Share

Ora 13:05

Arresti ndaj ish-kreut të SHISH, Balla: Ata që fërkojnë duart nga sukseset e SPAK, sulmojnë prokurorët me 'libër shtëpie' (VIDEO)

Duke komentuar arrestin ndaj ish-kreut të SHISH, [Vlora Hyseni](#), Taulant Balla u ndal edhe te opozita. Balla tha se PS ndjek të njëjtin standard edhe në këtë rast, duke mos bërë avokatin e askujt, ndërsa opozitarëve që sipas tij "fërkojnë duart nga sukseset e reformës në drejtësi" u kujton sulmet që Sali Berisha adreson të hënave ndaj prokurorëve të SPAK.



"Ne mbështesim SPAK të bëjë një hetim të pandikuar. Vlerësojmë punën e bërë nga SPAK. Rasti më domethënës është që i njëjti prokuror që heton rastin në fjalë, heton edhe udhëheqin e opozitës. Nëse çdo të hënë udhëheqësi i opozitës sulmon prokurorin, kjo është papranueshme. Sikurse ne duhet t'i garantojmë mbështetjen e plotë. Nuk ofrojmë mbështetje.

Sa i përket arrestimeve pa gjyq, duhet të jetë standard, që Shqipërinë mos ta bëjmë dele të zezë për paraburgimin. Rama ka të njëjtin standard gjithmonë, edhe në rastin në fjalë. Ndërkohë që ata që fërkojnë duart nga sukseset e reformës në drejtësi, duhet të mos harrojnë që është PS që e mori angazhimin, në 2016, pulat erdhën më kokën poshtë dhe duart lart, votuan vetëm ndryshimet në kushtetuese, më pas nuk erdhën për të votuar asnjë prej ligjeve. Janë ata që udhëheqësi i tyre shan me libër shtëpie prokurorët e SPAK, ndërkohë që standardi i PS, është që PS përshëndet në çdo rast punën hetimore të

prokurorëve", tha Balla.

SI.E./Shqiptarja.com

f Share

P.J./SI.E./Shqiptarja.com

TAG: PS SHISH vlora hyseni taulant balla

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

26 Shtator, 18:15

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Ish-kreu i SHISH ankim në Apelin e Posaçëm, kërkon heqjen e arrestit në shtëpi

29 Shtator, 14:22



'Territorialja', Balla: PD ta shqyrtojë draftin e saj në këshillat bashkiakë! Votimi më 8 tetor? Kreu i grupit PS: Presim Komisionin e Ligjeve (VIDEO)

29 Shtator, 13:19



'Do të fitosh 2 mijë euro', si u përdor emri i Taulant Ballës për të mashtruar Armand Dukën! Dy të arrestuarit kontradiktor në dëshmi, lihen në burg



Sokol Dema

29 Shtator, 11:37



SHISH dhe siguria kombëtare



Ekrem Spahiu

29 Shtator, 09:53



Ekskluzive/ Klodian Braho deklaroi në Këshillin e Sigurimit: Vlora Hyseni na doli gjatë hetimeve! Kreu i komanduar i SHISH: Deri tani s'kemi parë rrjedhje sekrete të cenojnë sigurinë

28 Shtator, 22:16



Ish-kreu i SHISH nën arrest/ Valteri: Standardin që Rama përdori për shkarkimin e Vlora Hysenit, duhet ta ndiqte edhe për Ballukun! Kthupi: Dosja e SPAK ka baza të forta!

28 Shtator, 21:36



Vlora Hyseni në 'arrest shtëpie'/ Dashi: SPAK të hetojë gjithë zinxhirin komandues të SHISH! Basha: Opozita të mos sulmojë institucionet, por të merret me fenomenin

28 Shtator, 18:43



Arrest i ish-kreut të SHISH/ PD kërkon dorëheqjen e Ramës, Spaho: Opozita di të bëjë vetëm zhurmë në Kuvend! Mazhoranca nuk është lëkundur

28 Shtator, 18:23



Balla takon Raporterin e PE për Shqipërinë: Shqipëria në krye të vendeve aspirante për anëtarësim në BE

28 Shtator, 16:48



FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit, Elvis Lila për herë të parë në publik! Merr pjesë në Këshillin e Sigurisë

28 Shtator, 16:47



Balla-eurolamentarëve në Tiranë: Vëreni në krye të axhendës ratifikimin e aderimit të Shqipërisë në BE

28 Shtator, 15:42



'Një nga rastet më të paprecedenta', Spahiu: Këshilli i Sigurimit të reflektojë për skandalin e kreut të SHISH

28 Shtator, 14:41

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.